



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

Procesverbal 3/2025

I Mbajtur në takimin e III-të të rregullt të KK-së me datën 28.03.2025, në sallën e Kuvendit në ora 10:00 nën kryesimin e Kryesuesit të KK-së, Xhavit Zariqi, në prani të anëtarëve të saj, OJQ-ve dhe Zyrtares për informim.

Fjalën Hyrëse – Kryesuesi të KK-së, Xhavit Zariqi;

Përsëritet për të gjithë të pranishmit, drejtor/e, media dhe shoqëri civile, të nderuar dhe të respektuar Anëtarë të Kuvendit të Komunës së Ferizajt. Po fillojmë me mbledhjen e III-të të rregullt të Kuvendit të Komunës së Ferizajt dhe për këtë mbledhje në bazë të materialit që e keni marr propozoj këtë rend dite:

Rendi i ditës:

1. Konfirmimi i pjesëmarrjes në mbledhjen e KK-së;
2. Miratimi i rendit të ditës;
3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar të KK-së;
4. Propozim - Vendim për Shpalljen Interes i Përgjithshëm të pjesës së ngastrës kadastrale; 721-0 Z.K. Nekodim me sipërfaqe 1426 m² pronë private;
5. Raporti i punës për Vitin 2024;
6. Propozim - Vendim për Shpalljen Interes i Përgjithshëm të pjesës së ngastrës kadastrale; 3536-0, 3093-0 dhe 1023-9 Z.K.Ferizaj, pronë private, me qëllim të këmbimit me pjesën e ngastrës kadastrale 180-10 Z.K. Talinocv i Jerlive, pronë e Komunës së Ferizajt;
7. Propozim - Vendim për anulimin e Vendimit me Nr. 01. Nr. 96 te datës 27.09.2024;
8. Propozim - Vendim për bartjen e mjeteve të të hyrave vetanake nga Viti 2024 në Vitin 2025;
9. Propozim - Vendim për caktimin e lokacionit, për vendosjen - ndërtimin e përkohshëm të zyreve të Organizatës “Miq të familjes Biden – Ferizaj;
10. Propozim - Vendim për Shpallje Interes i Përgjithshëm të pjesës së ngastrës kadastrale; 835-0 dhe 834-0 Z. K. Nerodime e Ulët, pronë private;
11. Propozim - Vendim për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Lapidarit të Dëshmorit “Gëzim Sahiti” në Fshatin Pojate;
12. Propozim - Vendim për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit për nevoja të banorëve të Fshatit Slivovë;
13. Propozim - Vendim për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Bustit të Dëshmorit “Hysni Kajtazi”;
14. Propozim - Vendim për caktimin e lokacionit për ndërtimin e pllakës përkujtimore për të zhdukurin e luftës Rustem Rustemi;
15. Propozim - Vendim për Miratimin e Memorandumit të Mirëkuptimit, ndërmjet Këshillit Danez për Refugjatë dhe Komuna e Ferizajt;

16. Pyetje dhe kërkesa dhe
17. Të ndryshme.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës e hapi mbledhjen e Kuvendit të Komunës të 4 me rregull dhe fillimisht e lexoi rendin e ditës së lartëcekur dhe pastaj pyeti nëse ka dikush diqka për të shtuar rreth rendit të ditës?

Sabri Murseli pasi përshëndeti të pranishmit theksoi se i propozoj edhe 3 pika të rendit të ditës e para është vazhdimi i afatit për shtëpinë e pensionistëve, pika 2 është shpallje interes i përgjithshëm dy ngastra kadastrale 3539 dhe 3538-0 z.k. Ferizaj me qëllim të rregullimit të parcelave.... dhe pika e 3 është shpallja interes i përgjithshëm pika e nenkalimit në nekodim 7210-0 pasi kosto është më e përshtatshme që të bëhet përmes kuvendit dhe jo përmes gjykatës për shkak të mungesës së mjeteve financiare.

Ndërsa sa i përket pikës me numër 6 propozoj të hjeket nga rendi ditës pasi kemi pranuar një ankesë nga banorët e fshatit.

Brahim Osmani pasi përshëndeti të pranishmit theksoi se pra pika 4 që nuk ka kaluar në kpf mos të hy edhe tash pasi ne e kemi kundërshtu në kpf mos i bini pikat që kuvendi ska të bëjë leje ndërtimi ose nëse ka të drejt ma thuaj ligjin se cili ligj ka të drejt.

Pakize Bujani pasi përshëndeti të gjithë theksoi se me lejoni që si përfaqësuese e qytetarëve si dhe atyre pakicë si dhe si përfaqësuese e subjektit që përfaqësoj më lejoni që të paraqes një pikë shtesë që është shkarkimi i nënkryetarit të tanishëm Danush Ademi si dhe zëvendesimi i tij me Qazim Rahmani që është propozim nga subjekti ynë politik. Arsyetim ju njoftoj që z.Ademi nuk është më pjesë e subjektit ton politik dhe vendimi i partis është që të zëvendësohet përfaqësimi ynë politik.

Si dhe paraqiti propozimin të cilin ja ka paraqitur kuvendit nga subjekti dhe përfaqësuesja e minoriteteve.

Flamur Istrefi pasi parshëndeti të pranishmit theksoi se sa i përket pikës në nekodim dhe dua të them ne si grup parlamentar jemi kundër dhe tjetra spe kuptoj rolin e kpf-s pasi ne aty kemi marrë vendim që të mos futet kjo pik në rend të ditës dhe i njejt drejtori prap e ka sjellë këtu këtë pikë andaj nga ky kuvend nga kjo foltore i bëjë thirrje prokurorisë që të hetojë këtë pikë të hetoj drejtorin se pse po insiton kaq shumë për këtë pikë cili është interesi këtu ju faleminderit.

Sabri Murseli theksoi se sa për sqarim nuk ka të bëjë me vendim për leje ndërtimore ka të bëjë me një vendim për shpallje të interesit të përgjithshëm 721-0 me sipërfaqe 1426m katror pasi vlera e kompenzimit do të shkoj mbi 400 mije euro, ndërsa ne kemi propozu që të bëhet shpallje e interesit të përgjithshëm të vlerësohet e masnej të shiqohet se si do të kompenzohet, nuk ka të bëjë me leje ndërtimore as me kurgjo thjesht me shpallje interes i kësaj prone.

Kryesuesi e nxjerre fillimisht per miratimin e rendit të ditës të miratuar në kpf ku kaloi me 37 vota për.

Kryesuesi do të paraqes të gjitha votat veq e veq për ti futur në rend të ditës.

Kush është për miratimin e pikës për vazhdimin e kontratës për penzionist që është plotësim ndryshimit e vendimit nr 01.109 i datës 30.09.2019 kjo pikë u fut me 37 vota për.

Për shpalljen interes i ëprgjitësh 3539-0 dhe 3538-0 z.k.Ferizaj janë 23 vota për, 7 kundër dhe 0 absnteim.

Dhe e kemi propozimin për rifutje në rend të ditës për shpalljen interes i pergjithshëm 721-0 kush është për?

Kjo pikë u fut në rend të ditës me 17 vota për, 14 kundër dhe 4 abstenime.

Për heqjen e pikës së 4 janë 22 vota për dhe 7 kundër dhe 0 abstenim. Pra hjeket.

Për propozimin e Pakizës janë 37 vota për, 0 kundër dhe 0 abstenim.

Fillimisht kam një kërkesë që pika për bartje të mjeteve të kaloj si e para e pikave të rendit të ditës,

Sa i përket konfirmimit nuk kam ndonjë konfirmim.

Sa i përket procesverbalit a ka ndonjë vërejtje dhe pasi ska u votua dhe kaloi me 37 vota për 0 kundër dhe 0 abs.

Sebahate Ajeti theksoi se organizata jonë : Të nderuar anëtar të Kuvendit të Komunës dhe anëtar të Komitetit për Politikë dhe Financa, bazuar në Ligjin mbi Vetëqeverisjen Lokale, Ligjin mbi Financat Lokale si dhe Ligjin mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësit paraqesim raportin financiar të organizatës sonë buxhetore (656) për periudhën Janar-Mars 2025 përfshirë të hyrat vetanake të realizuara si dhe shpenzimet buxhetore për të gjitha kategoritë ekonomike. Të hyrat Gjatë periudhës Janar-Mars 2025 u inkasuan gjithsej të hyra vetanake në vlerë prej 4,724,841.00€. Vlera e inkasuar në periudhën Janar-Mars të vitit 2025 në krahasim me vlerën e inkasuar të vitit 2024 ka rritje për 305.17%. Sa i përket krahasimit të realizimit të të hyrave në krahasim me planin kemi realizim prej 59.25%. Vlera inkasuar në total është e kënaqshme duke llogaritur se është tre mujori i parë i vitit dhe kemi realizuar të hyra mbi gjysmën e planifikimit. Në vazhdim paraqesim në mënyrë tabelare realizimin e të hyrave për periudhën Janar-Mars të vitit 2025 dhe krahasimet me vitin 2024.

Sa i përket ndarjeve tabelare e keni pa ndryshim sikur ne tabela, të gjitha këto mjete ndahen në ndarjen e pagesave për operator.

Kjo pikë pasi u vendos për tu votuar kaloi me 37 vota për 0 kundër dhe 0 abst.

Meqense Kryetari i Komunës ende nuk ka ardhur për të paraqitur raportin e punës ne vazhdojm më pikën e 4 të rendit të ditës dhe ia kalojm fjalën drejtorit Sabri Murseli.

Sabri Murseli theksoi se ky propozim ka të bëjë me shpalljen interes i përgjithshëm me arsyetimin se është marre kur është ndërtu projekti i nënkalimit në fshatin nekodim dhe nuk është këmbim është vetëm vlerësim i palujtshëm, Nëse e shohit të ardhmën me vazhdu në këtë formë e bëjmë nëse jo vazhdojm,ju lexoni pikën e 5 që pas vlersimit të vijë këtu për të ardhur tutje ne nuk lëshojmë leje ndërtimore atë punë e bën drejtorja e urbanizmit,

Brahim Osmani besoj që kryesia e kuvendit e ka procesverbalin dhe aty nuk ka diskutu drejtori kështu aty ka thanë ndryshe se qysh kena me dhan leje ndërtimore, pse po naj ndryshon fjalët këtu, kuvendi nuk jep leje u dasht kryetari mja këmbi me pronë tjetër na si grup edhe kë kpf edhe ne seanc edhe këtu jemi kundër që 3 her po nja sjellni.

Flamur Istrefi pasi përshëndeti të pranishmit theksoi se nuk e di pse drejtori u dasht me hy në ujra që nuk i takojnë, drejtor në arsyetim pika fundit thot në ajo që u tha më lart i propozoj kuvendit që ti propozoj kuvendit këmbmin me koeficient të ndërtimit, tu i pa rrethanat kryesus kërkoj që të shtyhet pasi para 5 minutave tha ska këmbim këtu vetem shpallje interes i vuri në lajthim.

Besim Haziri pasi përshëndeti të pranishmit theksoi na skem drejt si asamleist me dhën leje ndërtimore nëse drejtori po thot diqka tjetër letrat po thojn diqka tjetër un pres që sabri murselin kan me zan tja shti doren nxhep dikujt hajnia bahet qeshtu korrupsioni bahet qeshtu edhe nese ka hajni ktu bahet prej katit 1 deri 9.

Arian Imeri pasi përshëndeti të pranishmit theksoi se

Ky është një rast që e kemi pas edhe me heret, heren e fundit e kemi largu si pike të rendit të ditiespor si duket është insistimi i palës që të bëjë zgjidhje. Ne të gjithë e dijme rastin, në këtë prapësi veqeshtë implementu projekti i nenkalimit të fshatit Nikadin dhe është një projekt që është të shfrytëzohet prej qytetarëve edhe të atij komuniteti po edhe qytetarëve të jere.

Kërkesa e pronarëve për kompensim të pronës është legjitime çdo prapësi që shfrytëzohet apo që merret për interes publik duhet të kompensohet. Tash pronarët e tokës kanë pa interesin e tyre në këtë formë të kompensimit, unë mendoj që nuk duhet të marrim interesin e komunës. Nga të gjitha kërkesat deri tani që kemi kaluar për mendim të mirë kjo është më e interesuar për komunën.

Ne të zgjidhim problemin e tokës

private të shprehur, për mundësinë me ndërtime të pronarëve, pronarët kanë me pagë lejen e ndërimit, kanë me shpenzuar për ndërtime - kanë me angazhuar kompani të punës, kanë me pagë tatim në prapësi të teardhmen për ato metra, sa i përket aspekteve të tjerakemi edhe deklaratën e një studio profesionale rreth strukturës së objektit. Prandaj mendimi i mirë prapë po e tham është që nuk kemi formë më të benefitit të kompensimit.

Nëse ka probleme ligjore sepse është hera e parë që

për bëjmë kompesim të kësaj forme, vendimet të validohen ose jo nga MAPL-ja, përndryshe në këtë prapësi që e kemi marrë pa kompensim nuk mundemi të kalim sepse nuk mundemi të punojmë në askujt pa dashur të marrim fal, vetëm bëjmë fjalë a në këtë formë nëse lejohet ligjrisht apo me kompesim me mjete ose me ndërrim të kësaj prapësi.

Pra dallimi mes neve është veq forma e kompensimit.

Hatixhe Bungu Qerimi pasi përshëndeti të pranishmit theksoi se të drejtë u mundohet pak me një ndërrim mirpo simas materialit bëjmë fjalë për token në nekundim e si këmbejmë një leje të mbindërimit për 3 kate ku edhe po i kryen ndërtime për dakon unë po e kuptoj që komuna po mundohet me të bëjë zgjidhje mirpo kjo nuk mund të jetë zgjidhja më e mirë e mundshme pasi po i hapim rrugë edhe ndërtimeve të tjerë që të bëjmë një gjë të tillë unë po e pyes a ka bërë kërkesë fillimisht drejtori në drejtori të urbanizimit edhe ministri për këtë qeshtë ai mesigur ka marrë një përgjigje negative prandaj ka ardhur këtu dhe a jemi në kompetencën me të bëjmë një gjë të tillë kur personat kompetentët e kanë refuzuar një gjë të tillë, neve po na qitni në pozitë të keqe ndaj një investitori serioz mirpo anëtarëve të qytetarëve na kanë votuar me punë të drejtë e ndërrim e jo me kaluar kompetencat tona.

Amir Rexhepi, unë po duhet të pyes drejtorin pse drejtor se ke shpallur para se me nis punimet të ke punë pa procedurë të punës 3 herë deshtoj tash a për të ke deshtu këtu po shkon qart shumë çka kë më bënë ndërsa të thuash diçka tjetër drejtor koncentrohu pak mos ka një obligim tani po don me baraz.

Verona Isaku pasi përshëndeti të pranishmit theksoi kryetar është hera e parë që po del me të mbrojt tërhiqë këtë pikë pasi kjo ka ardhur veq përse të jetë këtu është hera kur mundesh me shpëtuar secilin asambleist andaj tërhiqë të lutem.

Adnan Selmani ne sjemi kundër as pronarit as objektit mirpo qka me i ba ati afër tij që është kur të thot ami edhe mu të drejten për 25 kate askush spe konteston statiken mirpo forma e këtyre ngastrave shkëmbimeve qka mi ba ati tjetrit.

Ejup Delolli pasi përshëndeti të pranishmit theksoi se kryetari ska nevoj mi mbrojt asambleistave as mju jep kurgjo po unë propozoj që qekjo punë mos mu nal mja dhan lejen atij, na jem kan qetu kur kuvendart e pdk e kemi ba tërheqejen na e kem propozu me hjek ateher na e kem pru sot, e dyta a e keni mapl a po thuni e pa ligjshme ju kthene a ja kena marr 14 ari tok a duhet mja kompenzu, e kem mundesin me fitu si komune ju opozita diqyah kqyrni mu grrebat diqysh un mendoj qe duhet me vazhdu.

Ibrahim Hyseni pasi përshëndeti të pranishmit theksoi se un sdeshta me fol po smujta pa e marr fjalen nje gje eshte e kjart këtu komuna ja ka marre 14 ari andaj nje forme e kompenzimit duhet te jete ju nuk dhat asnje forme te kompenzimit si propozim andaj un spe njoh pronarin mirpo nese eshte objektit i gatshem dmth nese i ploteson kushtet pse jo, nese ka shkelje te ligjit eshte ministria ajo qe i korigjon keto qeshtje mirpo me votimin e ksaj pike na ja hjekim barren komunes ndaj ati pronari. Une skam asnje interes ndaj tij mirpo kam interes me mbrojt komunen.

Shqipe Jashari pasi pershendeti te pranishmit theksoi se ju drejtor ju si fillim keni then vetem shpallje interes i pergjishem me pas dulen kompenzimi me kate si forme ju duhet te dini qe jan ekspert te fushes qe duhet te japin mendime per kete qeshtje, drejtor kjo eshte pergjegjsi e juaja dhe jo e kuvendit e ksaj forme duke u thirr ne interes te pergjithshem ose jepni parcela tjera e jo mbindertime.

Kryesuesi theksoi nese ska tjer per diskutim un e nxjerr ne votim kush eshte qe te kaloj pika per shpalljen interes i pergjishem 721-0 z.k Nekodim me sieprfaqe 1426 m2 kush eshte per dhe kjo pikë kaloi me 18 vota për, 15 kudner, dhe 3 abstenime.

Kryesuesi theksoi se duhet te vazhdojm me piken e rendit te dites qe eshte raporti i punes per vitin 2024 dhe ia kaloi fjalen Kryetarit të komunës Agim Aliut.

Kryetari...

I nderuar Kryesues i Kuvendit të Komunës,

Të respektuar anëtarë të Kuvendit,

Shoqëri civile, media,

Zonja dhe zotërinj!

Në këtë seancë të Kuvendit, në tryezë shqyrtimi e pune, kemi dokumentin kyç të qeverisjes lokale, me ndikimin e drejtpërdrejt për përmirësimin e jetës së qytetarëve, kemi para vetes, Projektbuxhetin e vitit 2024 dhe projeksionet e hershme për vitet 2025 dhe 2026.

Është pra kjo kornizë, ky planifikim, kjo llogaritje e saktë, që priorizon kërkesat e nevojat e qytetarëve, për të mos ndalur, ritmin e ciklin e punës në të cilën është futur tash e sa vjet Komuna e Ferizajt, duke ndryshuar çdo ditë, duke përmirësuar ndjeshëm shërbimet e duke realizuar vepra të guximshme publike.

Të hartosh buxhetin e Komunës, është një detyrë e nder, përgjegjësi e mbi të gjitha vizion, që të ngërthesh në ato shifra, pritjet e shpresat e qytetarëve, për t'u rritur mirëqenia e tyre e për të garantuar mirëfunksionimin e shërbimeve.

Ky dokument, është produkt i një pune të vazhdueshme, analitike, vlerësuese, shërbyer me ekspertizën më të mirë të ekipeve tona qeverisëse, për ta përmbledhur në këtë formë e në këtë vizion, që keni sot para vetes.

Nuk e themi vetëm ne, por është e mirëditur dhe e kualifikuar gjerësisht, se Ferizaj është lider në mesin e qendrave urbane, më të transformuara, më të zhvilluara, më të përparuara, kjo buruar nga energjia e pashtershme, idetë e qarta e ndjesia për nevojat e qytetarëve, përbetuar në parimet e sinqeritetit e ndershmërisë, bashkëpunimit e afrisë, që kanë bërë që suksesshëm e krenarë të meritojmë këtë epitet.

Energjia jonë nuk shterron, Ferizajn në punë, asgjë nuk e ndalon!

Zonja dhe zotërinj!

Qeveria lokale e administrata komunale që drejtoj, siç keni mund ta shihni, edhe mes këtyre faqeve të këtij buxheti, ka projekte, ka nisma, ka idetë dhe ka përllogaritjet e duhura, për ta bërë edhe më të begatë Ferizajn.

Janë pafund, projekte e nisma të reja, që shtrirë në kohë e në gjithë gjeografinë e Ferizajt, i japin kësaj të fundit, shumëfishim të vlerave, shumëfishim të mirëqenies, me punë e detyra të përfunduara, për t'i lënë shteg të lirë, inovacioneve e zhvillimit.

Buxheti i Komunës së Ferizajt për Vitin 2024, peshon 41,184,014.00€ që ndarë vetëm në fushën e investimeve kapitale, për vitin aktual 2023, kishim të ndara 12,114,664.00€ gjersa për vitin 2024 janë ndarë 11,337,196.00€ apo 777,468.00€ më pak për projektet kapitale.....

.....ndonëse si shifër totale, kallëzon rritje, rritje kjo që është bërë vetëm në kategorinë e pagave dhe mëditjeve, mallrave e shërbimeve, për të përmbushur planifikimet e Ligjit të Pagave, gjersa tek të gjitha kategoritë tjera buxhetore, kemi zbritje të buxhetit, që afekton padyshim në zvogëlimin e shumësisë së projekteve e nismave tona.

Në mbamendjen e gjithsecilit është e kujtueshme, po në këtë sallë, kemi vënë theksin për shkurtime të buxhetore. Edhe ky projektbuxhet, peshon më lehtë sesa në vitin paraprak, trend ky shqetësues e për të cilën kërkesave të qytetarëve i kemi dhënë zë, por assesi, ky trend nuk zbraps vullnetin tonë, energjinë tonë, që ferizajasve t'i ofrojmë dhjetëra projekte e nisma, në të mirë të tyre dhe gjithë komunitetit.

Të nderuar anëtarë të Kuvendit!

Miratimi i Buxhetit të Komunës, përtej një akti formal, është vendimmarrje e drejtpërdrejt për qytetarët, për të vendosur në kalendarin e punëve publike, prioritetet e qytetarëve në 365 ditët e ardhshme.

Gjykuar nga kjo lartësi kompetence e përgjegjësie publike, gjurmët për orientimin në nivel të ri të Ferizajt, mbeten tek gjithsecili, andaj në këtë ndërgjegje institucionale, besoj fuqishëm, për t'i dhënë autorizimet ligjore këtij dokumenti.

Çdo pore e shoqërisë, secila kategori shoqërore, të gjitha zonat rurale e urbane në territorin e Ferizajt, gjejnë veten në këtë dokument. Për këtë, jemi kujdesur që planet tona investive, të nisin që nga lagjet, në kontakt me secilin qytetarë të interesuar deri tek forumet e gjera profesionale, ndarë në fusha interesi, për ta bërë më gjithëpërfshirës, më të realizueshëm e më efikas, shpenzimin e parasë publike për vitin e ri kalendarik.

E gjelbërta është ngjyra, vetëdija, veprimi e vendimmarrja jonë në këtë mandat qeverisës, andaj në këtë pikëpamje, në planin e investimeve buxhetore, kemi paraparë projekte të veçanta, që Ferizajt i japin masive të gjelbërta, hapësira të pafundme rekreative, siç është projekti për zgjerimin dhe rregullimin e Parkut Liria....

.....pyllëzimin dhe rregullimin e Parkut tek Kodra e Sherretëve, Parku në hapësirën e Kompanisë “Pastërtia”, zbatimi i projektit për miniparqe në qytet e fshatra si në Prelez, Pleshinë e Neredime.

Në këtë kuadër, tashmë kemi nisur edhe procesin e konsultës publike për të jetësuar projektin për rregullimin e Tregut të Gjelbërt.

Lidhur me projektet e fokusit tonë transformues, infrastrukturës rrugore e gjer tek investimet më minore, shoqërohen nga analiza të mirëfillta, për ndikimin e efektet praktike për jetën e qytetarëve.

Në fushën e infrastrukturës, tashmë ka marr formën e saj, vepra madhore infrastrukurore – Nënkalimi për vetura dhe këmbësorë afër Stacionit Policor në Ferizaj, një investim unik ky kur lindi, për tu shumëfishuar si ide edhe në qendra të tjera të Kosovës e përtej saj.

Po kështu, kemi bërë ndarjen e buxhetit edhe për projekte të tjera që i japin trajtën transformuese, zemrës së Ferizajt, siç është projekti për rregullimin e sheshit nga rrethi i rrugës “Madeleine Albright” (tek Xhamia dhe Kisha) deri tek Teatri “Adriana”, duke nisur në këtë kuadër edhe rikonstruktimin rrënjësor të rrugës “Tahir Sinani”.

Po kështu, ndërhyrjet tona punuese do të ndodhin edhe në arteriet kryesore rrugore në qendër të qytetit, siç është projekti për rikonstruktimin e rrugës “12 Qershori” dhe vazhdimi i punëve për rikonstruktimin e rrugës “Ahmet Kaçiku”, për të vijuar edhe me rikonstruktimin e rrugës tejet të frekuentuar të qytetit, rrugës “Besim Rexhepi” dhe “Rizah Matoshi” si dhe rrugës “Naim Beka” – Pleshinë.....

.....pa lënë anash edhe një projekt me rëndësi të jashtëzakonshme për qytetarët, duke i shtuar ferizajasve edhe një shetitore, siç është projekti për rregullimin e shetitores në rrugën “Agim Ramadani” në zonën rekreative-sportive.

Në këtë pikëpamje, do të vazhdojnë punimet edhe në ndërtimin e Stacionit të Ri të Autobusëve e në Kompleksin e Varrezave të Reja të Qytetit, për t’u përmbyllur suksesshëm, sipas dinamikës dhe kohës së paraparë për realizimin e tyre.

Puna në fushën e infrastrukturës, do të vijoj edhe për vazhdimin e ndërtimit të kolektorëve për trajtimin e ujërave të zeza, siç është kolektori verior i kanalizimit fekal prej fshatit Talinoc i Muhaxherëve deri në fshatin Babush i ri si dhe ndërtimi i kolektorit Nikadin - Gurëz, faza e parë gjersa më në fund, pas vështirësive të shumta që vareshin e shkaktoheshin jo nga ne, pas dakordimit që kemi pasur me BERZh-in, do të nis dhe përfundohet projekti për ndërtimin e impiantit për trajtimin e ujërave të zeza, që i jep zgjidhje përfundimtare e afatgjate kësaj problematike në Komunën e Ferizajt.

Të nderuar anëtarë të Kuvendit!

Ferizaj, ndonëse ka shënuar suksese të shumta, duke përmbyllur pothuajse ciklin e investimeve bazike në infrastrukturën rrugore në zonën urbane dhe rurale, megjithatë, edhe në këtë projektbuxhet, janë paraparë asfaltimet e shumë rrugëve, arterie të reja që do të preken nga investimet tona në të gjitha fshatrat e Ferizajt, për të përmbyllur këtë cikël edhe në rregullimin e infrastrukturës rrugore në zonën urbane.

Në planin e shëndetësisë dhe mirëqenies sociale, qeverisja jonë, ka orientuar buxhetin e saj, në shtimin e kapaciteteve në infrastrukturën fizike shëndetësore, duke i shtuar zinxhirin të institucioneve shëndetësore lokale, godina të reja, themelata të reja, siç është projekti me Ministrinë e Shëndetësisë, për ndërtimin e objektit të ri të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare.....

.....po kështu, bashkëpunimi ynë i frytshëm me organizatën Qatar Charity, që rezultoi me përfitimin e mbështetjes për ndërtimin e objektit të ri të Qendrës së Mjekësisë Familjare nr. 2, pa lënë anash edhe objektet e reja shëndetësore, që ky buxhet parasheh t’i ndërtojmë në fshatra si Prelez i Muhaxherëve, Koshare e Rakaj.

Në aspektin e kujdesit social, parashohim ndërtimin e strehimores për gratë viktime të dhunës, Shtëpinë e Pensionistëve si dhe Qendrën për Rehabilitimin e përdoruesve të substancave narkotike.....

.....pa lënë anash edhe financimin që kanë programet e veçanta sociale si ai i shtëpive për mbrojtjen e fëmijëve, personave të moshuar si dhe shtëpia e komunitetit për personat me aftësi të kufizuara, që përmbushin orientimin tonë investimor, në garantimin e mirëfunksionimit të kësaj leve të rëndësishme të qeverisjes e shoqërisë.

Zonja dhe zotërinj!

Një nga segmentet më me peshë në qeverisjen tonë, ku fokusi ynë është i qartë, është edhe arsimi, kultura, rinia e sporti.

Qasja jonë për t'i lënë trashëgim brezave, vepra publike të mirëfillta, godina arsimore adekuate, po zbatohet, ndonëse me pengesa e vështirësi që nuk varen nga ne, përmes projekteve konkrete siç janë ndërtimi i shkollës së mesme në Ferizaj, aneksit tek shkolla "Gjon Serreçi".....

.....për të vijuar edhe në zona rurale si projekti për ndërtimin e shkollës në Manastirc, Neredime, Varosh, Tërrn e Mirash, shtuar disave prej tyre edhe hapësirat sportive, si salla e sportit në shkollën "Astrit Bytyqi", salla e sportit tek Spitali i Ri, salla e sportit në Fshatin e Vjetër – Bibaj, palestra sportive në Balaj e terreneve sportive si në Lloshkobare, Pleshinë, Prelez i Muhaxherëve dhe Varosh.

Infrastrukturës sportive e kulturore të Ferizajt do t'i shtohet edhe projekti me rëndësi të veçantë për sportistët e sportdashësit – Renovimi tërësor i brendshëm i Palestrës së Sporteve "Bill Clinton", ndërtimi i palestrës së sporteve luftarake, ngritja e obeliskut kushtuar Kuvendit të Ferizajt të vitit 1908.....

.....ndërtim i fushave të pingpongut dhe shahut në qytet, ndërtimi i tribunave në stadiumin "Tefik Çanga" në Tërrn, fushat e futbollit të madh në Dardani, Saraishtë dhe Sazli, si dhe finalizimi e përgatitja për përdorim publik të objektit të Qendrës Rinore dhe Kinemasë, pa lënë anash edhe projektin unik që kemi idenë ta realizojmë, ndërtimin e fushave sportive me taraflex.

Në këtë drejtim, është i mezipritur edhe investimi për Stadiumin e Ri Futbollistik "Ismet Shabani" në Ferizaj, për të cilin, tashmë ka nisur studimi i fizibilitetit për zonën e Kompleksit Sportiv prapa Palestrës "Bill Clinton" në Ferizaj, ku bashkë me Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, kemi bashkërenduar veprimet, konkretizuar përmes marrëveshjes së bashkëpunimit, në zbatim të këtij projekti me peshë të jashtëzakonshme, për të cilën bashkë, pritëm gjatë.

Në fushën e shërbimeve publike dhe emergjencë, do të vijojnë punët me përkushtim për mirëmbajtjen e hapësirave publike, por edhe përmes zbatimit të projekteve të veçanta, siç është ai për vendosjen e monitorëve dinamik në rrugët "Driton Islami" dhe "Gursel e Bajram Sylejmani", rregullimi i udhëkryqeve rrugore në zonën urbane.....

.....projekti për ndërtimin e pritoreve, vendosjen e hidrantëve, rregullimin e qasjes infrastrukturore për personat me nevoja të veçanta, mirëmbajtjen dhe zgjerimin e ndriçimit publik, rikonstruktimi i rrugëve të reja dhe trotuareve në fshatra dhe qytet, rregullimi i shtretërve të lumenjve e kanaleve ujore.....

..... për të vijuar edhe me projekte të rëndësishme kapitale siç janë ndërtimi i dy objekteve për nevoja të Komunës në rrugën “Liman Rekaj” dhe në fshatin Gurëz, si dhe rregullimet në objektin e Brigadës së Zjarrfikësve, duke investuar edhe në furnizimin e tyre me pajisje.

Në fushën e bujqësisë, pylltarisë si dhe zhvillimit ekonomik e turizmit, në këtë projektbuxhet parashihet vazhdimi i punëve në dobi të bujqve e fermerëve ferizajas, duke krijuar edhe infrastrukturë e lehtësira për veprimtarinë e tyre.

Në këtë mes, kemi buxhetuar projektin e veçantë, për ndërtimin e Qendrës së Panairëve – Hipodromit në fshatin Papaz, ndërtimin e silloseve për ruajtjen e grurit në fshatin Pojatë, rregullimin e rrugëve të arave dhe hapjen e kanaleve kulluese për tokat bujqësore, për t’u fokusuar edhe në projektin që synojmë të rrisë turizmin në Ferizaj, përmes ndërtimit të infrastrukturës për zonën turistike në Jezerc.

Të nderuar anëtarë të Kuvendit!

Si edhe në çdo dikaster të qeverisjes lokale, edhe në fushën e administratës, pronës, kadastrit e gjeodezisë, do të vijojmë me punë e projekte për ta modernizuar shërbimin tonë administrativ, duke i ofruar qytetarëve, lehtësi, efikasitet e qasje të shpejt në shërbime, për të cilat kemi bërë e vazhdojmë të bëjmë përpertime të dukshme.

Ne, gjatë këtij rrugëtimi qeverisës, mësuam shumë nga qytetarët. Janë ata me të cilët ndajmë vendimmarrjen tonë. Në hartimin e këtij buxheti këtë vit, organizuar në formë krejt të veçantë, gjithëpërfshirja ishte kryefjala, ku grupet e interesit, grupet e specializuara sipas fushave, të gjitha kategoritë shoqërore, të zgjedhurit e qytetarëve u përfshinë me propozimet e tyre. Ky projektbuxhet është i tyre, është zëri i tyre, janë themelet mbi të cilat marrin përgjigje kërkesat e tyre, andaj ferizajasit meritojnë punën, përgjegjshmërinë, mirëqenien.

Të tilla synime ka ky projektbuxhet, prandaj, duke ju falënderuar për vëmendjen gjatë paraqitjes sime të projekteve e nismave tona buxhetore, duke besuar në lartësinë e përgjegjshmërisë tuaj para qytetarëve, jam i bindur se ky projektbuxhet, do të marr votën tuaj pozitive, për t’i thënë Po, ritmit të pandalshëm të ecjes përpara të Ferizajt.

Ju faleminderit!

Brahim Osmani...

Buxheti është shtylla në të cilën bazohet Komuna për një vit dhe në buxhet jepet drejtimi që e merr qyteti ynë për të gjithë vitin.

Për fat të keq, edhe viti 2024 nuk do të jetë më i ndryshëm se vitet e kaluara, me projekte që fillimisht shkruhen në letër e më vonë ju merren mjetet financiare.

Ky është buxhet i përsëritur, ku ato projekte që s'kanë filluar më herët anipse kanë figuruar se po buxheton, janë përsëritur tash kinse do të fillojnë në vitin e ardhshëm.

Por, ne jemi të sigurt se do të ndodh si më parë, sepse ky ekzekutiv i pa aftë na e ka dëshmuar modelin se punon vetëm aq sa punojnë edhe për vete.

Projektet që janë paraparë edhe tash me të njëjtat shifra si më herët e që s'kanë filluar as viteve paraprake e s'do të nisen as vitin e ardhshëm janë peng i asaj për të cilën njihet PDK-ja.

Qyteti i rënduar nga borxhet që janë shkaktuar nga keqpërdorimet e pasqyruara edhe në Raport të Auditorit po bëhet gërmadhë edhe në terren ashtu si në dokumente ku s'po mund t'u dilet në krye obligimeve.

Pra, në fund, ashtu si çdoherë tjetër, paratë e secilit projekt do të barten në nëntokë ose thënë me gjuhën e kryetarit, në nënkallim.

Komunës sonë nuk i mungon buxheti, në fakt për vitin e ardhshëm ai është mbi 3 milionë euro më i madh. Por, për shkak të mënyrës së keqe të menaxhimit, edhe me buxhet më të madh, si Komunë jemi më e varfër.

Ju keni dëshirë ta akuzoni Qeverinë, në fakt e keni halë në sy Ministrin Hekuran Murati dhe shpifni për të se gjoja i bllokoi projektet, a në fakt nga granti i përgjithshëm qeveritar nga Qeveria e Republikës së Kosovës do të alokohen 16 milionë e 154 mijë e 546 euro më shumë, ose 1 milionë e 690 mijë e 662 euro më shumë se vitin e kaluar. Granti i plotë qeveritar arrin në 35 milionë e 774 mijë euro ose 86% e të gjithë buxhetit komunal. Vetëm 5 milionë e 400 mijë euro janë të hyra vetanake, dhe ju krejt çka dini të bëni është ta shani Qeverinë dhe Hekuran Muratin.

S'keni nevojë të shpifni vetëm pse i frikësoheni Hekuran Muratit. Nejse, unë ju kuptoj që ju nuk i keni aftësitë e kapacitetin që të ballafaqoheni me argumente me të, prandaj shpifja është i vemti mjet me të cilin mundoheni ta godisni, por e keni të kotë. S'keni faj që frikësoheni!

Ky është buxhet i çuditshëm. Përshembull i keni nda ma shumë se 70 mijë euro për makina fotokopjuese e pajisje të tjera, ndërkaq vendimet dalin pa ngjyra. Nejse, ato vendimet e rëndësishme ku jau ndërroni kombësinë fëmijëve tuaj i bëni me ngjyra.

Kryetar, 400 mijë euro i keni parapa për furnizime për zyrë, 665 mijë euro furnizime me ushqim dhe pije - jashtë drekave zyrtare, 26 mijë euro për furnizim me veshmbathje! A mundesh me na tregu çka është kjo punë?, knej 400 mijë euro për furnizime me ngjyrë.

Në mirëmbajtje të shkollave i keni nda 169 mijë euro, ndërkaq papastërtia më e madhe në krejt institucionet është në shkollat tona.

104 mijë euro i keni nda për një vit për shpenzime të informimit publik. Ku po shkojn ato para, Përveç kësaj s'ka fije transparence se as seancat e Kuvendit Komunal nuk i transmetoni!

Për shpenzime të vendimeve të gjykatave i keni parapa 49 mijë euro, e për përmbarues sa? A e din që veç vitin e kalunë 592 mijë euro ja ke dhënë përmbaruesit?! Raporti i Auditorit e ka nxjerrë, s'po e them unë.

Edhe po më intereson a i keni pajisë krejt militantët me mjete bujqësore që i keni ulë 250 mijë euro në subvencione te pagesat për përfitues individualë a? Prej 634 mijë e 500 eurove në 384 mijë e 500, fiks 250 mijë më pak. Në vend se me i rritë investimet në bujqësi, ju e krasitni buxhetin aty.

Në shpenzime kapitale, 777 mijë euro më pak se vitin e kalunë. Ku po i çoni paret, Qeveria po i jep 4 milionë euro më shumë sivjet.

200 mijë euro për zhavor për hapje të rrugëve të reja pa tregu ku i bjen me i marrë këto pare me i bartë diku tjetër se nuk shtroni asgjë.

500 mijë euro për riparim të ndriqimit publik, ama ku? A veç me i dhanë paret te naj kompani, pat e s'pat nevojë?

Keni nda pare për ndërtim të objekteve për nevoja të Komunës nëpër fshatra e edhe në qytet, kah 50 mijë euro. Zyret e vendit tash janë mshelë, kah këto pare?

Qysh o Kryetar për asfaltim të rrugëve në Rahovicë e në Talinoc të Muhaxherëve veç 40 mijë euro? Për rregullim të parkut në Prelez të Muhaxherëve e ndërtim të fushës sportive në Surqinë e Tërrn nuk e ke nda asnjë cent?

A po t'kujtohen premtimet? A tash u kry se i ke marrë votat?

I ke nda veç 50 mijë euro për rrjet të kanalizimit në Greme e Mirosalë. A e dini sipërfaqen e Gremes? A e dini gjendjen aty? Qe sa jeni t'u u marrë me ujin e pijshëm në atë fshat.

Më tej, 150 mijë euro për rregullim të tregut të kafshëve dhe ndërtim të strehimores së qenve. A e dini qe sa e keni fillu e edhe sa ju duhet deri në përfundim?

Veç 30 mijë euro i ke nda për ndërtim të QKMF-së me bashkëfinancim me Ministrinë e Shëndetësisë. Në anën tjetër e akuzoni për vonesa Qeverinë, a nuk ndani as buxhet të mjaftueshëm e shkaktoni pengesa edhe vanim në projekt.

Ke parapa 50 mijë euro me ndërtu Qendër të Mjekësisë Familjare në Koshare. Qysh me t'besu që sivjet bën diçka kur njëjtë ka qenë edhe para 1 viti e nuk ka lëvizë kurgjo. Në fund i ke çu paret në pagesa tënborxheve e nënkallim që po t'i rritë edhe ma shumë borxhet.

Për Stadium të Ri të Qytetit 30 mijë euro. Kjo nuk është veç hajgare po edhe ofendim për të gjithë sportdashësit dhe qytetin. 330 mijë euro ka qenë shumë, 300 mijë i ke avullu tjera kah, 30 mijë i ke lanë me figuru se edhe këto i hekë. Kaq është interesimi yt për sportin të cilin e ke shkatërru bashkë me këtë aksionerin profiter këtu përpara.

Për shkollën e re në fshatin Varosh asnjë cent për vitin e ardhshëm. Po ti renovoje të vjetrën bile, është e tmerrshme ku mesojnë ata nxënësia e ku japin mësim mësuesit e arsimtarët.

Veç 30 mijë euro për kolektorin e kanalizimit fekal prej Talinocit deri në Rahovicë. Kjo është skandaloze kaq e ulët, po ju as këto nuk i leni, i merrni krejt.

Kryetar ti me këtë buxhet veç po e dëshmon që ja ke marrë shumë inati këtij qyteti që t'ka besu me qeverisë e ti po ja kthen me regres. Arsyen e din ti! Nashta edhe nëntoka i ka fajet, të cilës tash po i jep qasje me nënkalime.

Edhe pse është bërë kogja vonë, ndoshta ende mujna me t'ndihmu me bërë diçka të mirë.

Duhesh me fillu me ndërto një çerdhe në Talinoc të Muhaxherëve se gjithë ajo hapësirë, gjithë ata banorë nuk kanë çerdhe. Ti e ke premtu. Dy vjet të ikën. Vitin tjetër nuk e ke parapa.

Kryetar duhesh me ndërto një trotuar në Softaj, Pojatë e Papaz se fëmijët ecin në rrugë dhe e kanë shumë rrezik qarkullimin për në shkollë.

Kryetar në Mirosalë është kallë Qendra e Kulturës, asnjë cent për me renovu. A veç prej Ministrisë po pret sikur për Gjimnazin "Ismail Qemali" a?

Kryetar e ke harru Parkun e Pishave në Rahovicë ku qitshe foto, tash pa mirëmbajtje është bërë veç lokacion për përdorues të narkotikëve.

Kryetar në Sojevë, Dardani, Zllatar asnjë pikë të ujit të pijshëm nuk e kanë. Ti veç rrugën jau ke prishë; ne jse e keni të njohur këtë metodë për me prishë që mandej me hapë tender për me ndreqë.

Ti le që e ke shkatërru futbollin po atë pishinën gjysmë-olimpike a e ke harru a? Kujtoje pak fushatën se të erdh gati tjetra e ti del i thu tani premtimet e njejt se asnjë nuk e ke realizu.

Prej QKMF-së në Prelez të Muhaxherëve i keni hekë paret, për besë e turpshme është nëse kishit pasë turp.

Xhavit Zariqi, ty Brah skam qare pa ti than nja dy fjale, ktu jem tu fol per raport te punes dhe jo politike dhe qdo investim qe behet eshte pune e kuvendit dhe qeveria nese investon duhet me lobu per me ardhe aty dhe normalisht qe duhet te permendet bile sa i perket stadionit une e di qe u ba shume pune ne menyre qe me ardhe ky projekt un e kuptoj opozit duhet me kundershthu mirpo jo ne kete forme qka je tu thane ato projekte qe ki vrejttje duhet me than e jo kshtu per raport tpunes.

FLAMUR ISTREFI

Fjalimet e kryetarit aliu jane gjithmone interesante per tu degjuar per faktin se jane ne shperputhje te plote me premtimet e tij, me vet raportin por edhe me realitetin. Ne boten e tij imagjinare per te cilen mundohet te na bind edhe ne, gjithqka eshte ne rregull, edhe atehere kur i ndodhin skandale me leje ndertimore ne parqe, edhe atehere kur i dalin selamet qe i qon nepermjet mesazheve ky sillet sikur ska ndodh asgje, po ky ska faj, se ne rrethana normale ky eshte dashur te jete sot duke raportuar ne nje vend tjetere e jo ne kete kuvend

Raporti i punës për vitin 2024 edhe pse siperfaqesor, tregon për dështimin e qeverisjes komunale në arritjen e qëllimeve që vetë ata kishin planifikuar. Ky raport, me të dhëna të pergjithesuara e statistikore, është larg realitetit, realitetit të hidhur, të një viti qeverisjeje ku institucionini i komunes se Ferizajt është

kthyer në shërbim të interesave të grupeve të caktuara dhe individëve të privilegjuar, duke favorizuar kompani të njëjta për tenderë, konkurse të kurdisura dhe punësime familjare.

Ne fjalimin e tij, kryetari Aliu, si edhe here te tjera, e ka fokusin te gjelbërimi, parqet dhe ambienti. Por, e verteta është krejt ndryshe nga ajo qe ai thote, pasi qe dy parqet në qytet që ishin planifikuar për t'u përfunduar, njëra është dhënë për zyrë administrative dhe tjetra ka filluar vetëm si projekt (tek pastertia). Po ashtu, për parkun e Gjon Sereqi dhe atë të Spitalit nuk ka asnjë përmendje.

Dy parqet tjera qe natyra i ka kriju, duke u thirr ne zgjerim e tyre, njeren e ka betonizu te sherretet e ndersa tjetren ka tentuar ta jap per ndertimin e nje restaurantit per dostin e tij.

Perndryshe, ne raportin qe e kemi para nesh, nga zyra e personelit, janë treguar të dhëna për pensionimet dhe dorëheqjet, por asnjë informacion nuk është dhënë për numrin e të punësuarve gjatë vitit 2024.

Njejte eshte edhe te zyra e auditimit të brendshëm, qe ka raportuar se janë bërë 7 auditime, prej te cilave jane dhënë 22 rekomandime, e ku vetëm 4 janë zbatuar, e ku nuk është asnje e dhene se cilat janë rekomandimet e zbatuara dhe cilat janë ato 18 rekomandimet që nuk janë realizuar.

Një tjetër çështje shqetësuese është te zyra ligjore, ku komuna e Ferizajt ka marrë pjesë në 1937 seanca gjyqësore gjate nje viti, e që do të thotë se mesatarisht komuna ka pasur 8 seanca ne ditë. Kjo per mua eshte një shifër e paprecedentë qe tregon se komuna e ferizajt dhe zyrtaret e saj shumicen e kohes e kane kaluar neper gjykata.

Po ashtu, në raportin e Drejtorisë së Financave, nuk janë përmendur shpenzimet për gjykata dhe për procedura të tjera ligjore, edhe pse të gjithë e dimë që për shkak të keqplanifikimit, komuna e Ferizajt humb çdo vit qindra mijëra euro për këto shpenzime.

Te dhena te njejta edhe pse siperfaqesore e teper shqetesuese, jane edhe neper drejtorite e tjera, por une do ti listoj disa fakte te cilat kryetari aliu nuk i ka paraqitur ne raportin e tij propagandues

Pra:

1. Nuk e ka paraqitur skandalin me asfaltin në fshatin Mirash, asfalt i cili është paguar, por nuk është shtruar asnjehere atje ku ishte paraparë.

2. As faktin qe Nënkalimi i ri, njësoj si ai i mëparshmi, ka emrat e firmave të gravuara dhe jo emrin e qytetit. Kryetar aliu duhet t'i tregoj qytetarëve se pse e lejon një gjë të tillë? A i ka ndonjë borxh qyteti i Ferizajt ketyre operatoreve te cilet kane marr miliona per punen e tyre apo kryetar aliu ka hy personalisht në obligime me këto firma?

3. Nuk e ka paraqitur as faktin qe Zyra e Prokurimit per koncerte per "Ditët e Diasporës" kishte ndare një shumë mbi 390 mijë euro, dhe e ka anuluar dy herë vetem pas presionit të opozitës.

4. Po ashtu seshte paraqitur në kete raport deshtimi për privatizimin e çerdheve dhe të tregut te gjelbert. Pas tri seancave, çerdhet i ke kaluar si pikë, por në praktike ato kanë dështuar, ndersa pazari te ka deshtuar qysh ne Kuvend.

5. Njejte, Nuk e ka përmendur faktin se i keni gënjyer publikisht edukatorët, duke u thënë qe te vazhdojnë punën dhe pastaj do të pagohen, por asnjëherë nuk i keni paguar. Behet fjale per muajin Mars

6. Nuk e ke paraqitur as deshtimin lidhur me procesin e zgjedhjeve të kryetarëve të fshatrave, proces i cili do duhej të përfundonte brenda një muaji, por kanë kaluar 15 muaj dhe ky proces ende nuk ka përfunduar

7. Njejte nuk e ke përmendur faktin që mësimi ka filluar pa nxehmje dhe drejtoret kanë pasur detyrën të bartin dru nga shkolla në shkollë. Pra edhe ketu ke deshtuar

8. Po ashtu, Komisionet e rekrutimit të punonjësve i ke bërë jo-profesionale, vetëm për të favorizuar njerëzit e tu të afërt, njerez te politikës dhe të familjes. Ka shumë raste të favorizimeve të tilla, si rasti i kumatës së drejtoreshës së Kulturës që u anulua konkursi pastaj, rasti i punesimit te balldyzkës tuaj, si dhe rasti i drejtorit te Shërbimeve Publike, i cili ka fyer dhe sharë në këtë Kuvend, e si shoerblim është avancuar në zëvendës drejtor në Gjimnazin “Shaban Haxhani”.

9. E ke lene ne harrese e se ke përmendur transportin urban, per te cilin ke bere shume buje, e i cili deri tani nuk eshte realizuar.

10. Se ke paraqitur problemin e mbeturinave qe ka qenë një problem kryesor, e qe ti dhe koalicioni yt nuk keni marrë mundimin të vini në seancën e jashtëzakonshme që e kemi thirrur për të gjetur një zgjidhje për kompaninë “Pastertia”.

11. Gjatë vitit, duhet theksuar se një numër i madh i zyrtarëve tuaj është paraqitur në gjykata dhe prokurori për shkak të aktakuzave dhe hetimeve per keqperdorime

12. Po ashtu, edhe shtëpia e pleqve nuk ka filluar as këtë vit.

13. Qe akoma ne vitin 2025 kemi probleme me uje, kanalizim dhe me qen endacak

14. Qe kembimet e dyshimta te pronave kane qene peioritet i yti, e qe ke tentuar te kembesh prona me leje ndertimore ose mbindertim

15. Qe per spitalin dhe stadiumin e qytetit nuk eshte bere asnje levizje serioze

16. Qe per shkak te keqmenaxhimit i ke shkaktu humbje te medha buxhetit te komunes

17. Dhe mbi të gjitha, qe ke treguar qe je nje frikacak dhe zgjedh heshtjen për të gjitha problemet dhe skandalet që kanë ndodhur gjatë qeverisjes tënde.

Pra, ky raport është mbushur me të dhëna kozmetike, por në realitet, viti 2024 ka qenë një vit i dështuar, një vit që shpresojmë të mos kthehet kurrë në këtë formë qeverisjeje.

Flamur Istrefi

Sot po diskutojme për një temë tepër me rëndësi, për Projekt buxhetin për vitet 2024-2026, Projekt buxhet I cili percakton kahjen e zhvillimit të komunes tonë. Buxheti i vitit 2024, sic shihet karakterizohet me një rritje të ndjeshme krahasuar me vitin aktual ku nga 38 milion sa ka qenë këtë vit, pritet të bëhet 41 milion Euro, ku rritja kryesore shkon në paga dhe shtesa të cilat nga 16 milion janë rritur në 20 milion Ose për 4.3 milion me shumë.

Ndërkohë që kemi ulje të buxhetit në kategoritë që I prekin drejteperdrejte qytetaret sic jane shpenzime komunale, subvencione si dhe investime kapitale. **Shpenzimet komunale** nga 950 mijë euro sa janë tani, në buxhet për vitin e ardhshëm janë planifikuar 564 mijë euro ose 385 mijë euro me pak, e që ky buxhet do të jetë i pamjaftueshëm për të mbuluar shpenzimet komunale, e si pasojë e kësaj do detyrohemi të paguajmë edhe shpenzimet tjera shtese permbarimore pasi që lendet tona do të përfundojnë në permbarues për shkak të mos pageses ndaj kompanive publike. Një gjë e tillë ka ndodhur në të kaluarën dhe Po ndodh Edhe tani, ku kompanitë publike Po i drejtohen permbaruesve në vazhdimësi.

Sa i perket subvencioneve, kete vit kishim te ndara 1 milion e 200 mije euro, para 3 muajsh në Kornizen Afatmesme Buxhetore per vitin e ardhshem i kishim te planifikuara 1 milion e 350 Euro, Ndërkohë qe sot në buxhetin për Vitin 2024 për subvencione kemi te planifikuara 950 mije euro. Pra, 250 mije euro me Pak se vitin aktual, dhe 400 mije euro me Pak se sa ajo Qe vet ky ekzekutiv na kishte paraqitur para 3 muajsh. Mos te harrojme se për qytetin e biznesin, per ndihme te drejte për drejte për bizneset e reja, për ato me veshtiresi dhe për te gjitha bizneset ne teresi Jane planifikuar vetem 80 mije euro Ose kthyer %, vetem 0.2 % edhe ato ne turizem. Kjo pra eshte mbeshtetja e drejteperdrejte qe i japin bizneseve ne komunën tonë keta te cilet thirren vazhdimisht ne ate qe jemi kryeqyteti i biznesit.

Tek Kategoria Mallrat dhe sherbimet ka nje rritje te lehte ku nga 7.5 milion Euro Jane planifikuar 8 milion,

Ku pjesa me e madhe shkon në sherbime dhe mirembajtje. Vlen te theksohet se edhe këtë vit jane disa shuma tek mallrat dhe sherbimet te cilat për ne jane shume te larta dhe Po ashtu te pa qarta, si p.sh.:

- 1) furnizimi me ushqim dhe pije(jo dreka zyrtare) 665 mije euro, per cfare perdoret kjo shume
- 2) sherbime kontraktuese tjera 1.6 milion ne vit (per cfare sherbime perdoren këto 1.6 milion Euro)
- 3) Qiraja per ndertesa 34 mije euro(cilat ndertesa)
- 4) qeraja për makineri 14900 Euro si dhe mirembajtja Rutinore 186 mije euro.

Por ajo Qe vihet ne pah me Se shumti eshte shuma qe eshte ndare për shpenzime te marketingut: 118 mije euro në vit nga ta cilat” Reklama dhe Konkurse 8 mije euro, Botimet e publikimeve 6 mije dhe Shoenzimet per informim publik 104 mije euro. Qe i bjen rreth 325 euro në dite per Reklama dhe informim publik. E para mendoj qe jane shume se ska nevojte me u pagu kaq shume dhe e dyta, ke po e paguajme me keto mjete Se me sa e di televizionet lokale dhe Portalet e komunes tone skane ndonje kontrate Te kesaj shume.

Apo ndoshta këto mjete Jane Te dedikuara per televizionet nacionale për te bere Reklama dhe marketing vetem për kryetarin e komunes.

Tek shpenzimet kapitale, kemi ulje Te buxhetit krahasuar me vitin paraprak. Ne vitin 2023 per shpenzime kapitale kishim 12 milion e 114 mije Euro nderkohe qe për vitin 2024 kemi te planifikuara 11 milion e 337 mije euro e qe i bjen rreth 770 mije euro me pak. Pra ne vend qe te cdo vit te kishim nje buxhet me le lartë për investime kapitale, qe te Investohet në Projekte konkrete, bejme te kunderten e zvogelojme kete buxhet. Po ashtu buxheti per investime kapitale eshte me i ulte edhe Se planifikimi Qe e keni paraqitur ne kornize Afatmesme Buxhetore ne kete Kuvend. Ne KAB jane planifikuar 12 milion e 250 mije euro e sot keni ardh me propozim me 900 mije euro me pak.

Po kaq sa jane, investimet kapitale do duhej te ishin Te shperndara sipas nevojave dhe kerkesave te qytetareve e jo te orientohen dhe te selektohen lagje dhe fshatra te caktuara me Projekte te shumta, e te tjerat te lihen në harrese. Kemi fshat qe ka 4/5 Projekte e kemi te tjere qe e kane 1 ose asnje.

Neper degjimet publike me qytetar Qe Jane mbajtur lidhur me buxhetin për vitin 2024 shumica e kerkesave te qytetareve jane pranuar sipas Raportit por qe anash në arsyetim thuhet Qe për keto këto kerkesa do Te shqyrtohen mundesite.

A e dini si i bjen kjo? Njejte sikur kryetarit Aliu Qe kishte premtuar

Liqenin Artificial me kend te lojerave e me amfiteater,

Parkun te “Gjon Serreq” me parking nentokesor, park, kend te lojerave dhe hapesire për te moshuarit, ParkunTe stacioni autobuseve dhe shtepine e pensionisteve. Pra te njejtin fat do ta kene edhe keto kerkesa te qytetareve, nuk do te realizohen asnjehere.

Po ashtu, tek investimet kapitale jane disa Projekte Qe e kemi thene edhe ne te kaluaren te cilat kane filluar me heret e kurre nuk dihet kur përfundojnë psh: Ndertimi i Stacionit te autobusev, ku veqse eshte nenshkruar kontraten ne vitin 2022 e ku punimet duhet ti mbaroj per 36 muaj, e për cudi ketu eshte vleresuar Qe duhet te ndajme buxhet edhe në vitin 2026 per te,

Njejte edhe rregullimi i tregut te kafsheve dhe ndertimi i strehimores se qenve qe sperfundon kurre, Po ashtu renovimi i palestres se sporteve Bill Clinton Qe sa vite vetem renoviert e kurre sperfundohet, njejte eshte edhe me Ndertimi i qendres rinore dhe kinemase Se qytetit, Ndertimi i Aneksit te shkollës “Shaban Hashani”, si dhe nderimi i shkolles fillore në Terrn

Po ashtu ne kete buxhet jane futur edhe disa Projekte vetem sa për te thene, e qe te gjithë e dime Se nuk do Te realizohen, Te Pakten jo tani: sic Jane stadiumi ismet Shabani, Ndertimi i shtëpisë se pensionisteve, QMF ne Koshare dhe në Rakaj etj.

Eshte interesant fakti qe edhe pse ulen investimet kapitale janë disa projekte Qe kane rritje te vlerave në vazhdimësi cdo vit, siç është riparimi dhe zgjerimi i rrjetit Te Ndriqimit Publik si dhe rikonsruimi i ndriqimit publik ku jane planifikuar 800 mije euro në vit, Pastaj zgjerimi dhe rregullimi i Parkut “Liria” qe eshte është shpallur tenderi dhe eshte lidhur kontrata me Operatorin ekonomik për 500 mije euro,e ne KAB Jane planifikuar 665 mije euro e sot ne buxhet 1.1 milion, pra eshte dyfishuar.

Njejte eshte edhe me pyllëzimin dhe rregullimin e Parkut ne Kodren e Sherretve. Eshte lidhur kontrata këtë vit per 770 mijë euro nderkohe qe tash per tri vitet e ardhshme kerkohen edhe 1.1 milion Euro.

Rasti me interesant eshte projekti Asfaltimi dhe zgjerimi i rruges Agim Ramadani ne zonen rekreative sportive Qe në buxhetin vitin e kaluar dhe në Kaab para 3 muajsh ka qene 180 mije euro. Tash e kemi 550 mije. Pra para tre muajsh ky Projekt behej per 189 mije euro ndersa tani e njehta 550 mije. Po besoj qe Arsyet e rritjes Se shumave ne shumicen e projekte tashme i dini te gjithë. Edhe besoj qe e dini Se projektet dhe tenderet kryesore në Ferizaj i marrin kompanite e njehta për te cilat pastaj duhet vene edhe kriteret specifike për t’i favorizuar këto kompani te cilat te aferta me pushtetin dhe për ti eliminuar kompanite tjera Qe te mos aplikojne, gje te cilen e ka konfirmuar edhe auditori i pergjithshem tek Te gjeturat qe i ka paraqitur per komunën tonë.

Prandaj, kete buxhet i cili nuk përfshin në menyre Te barabarte kerkesat e qytetareve, qe eshte selektiv, qe kryesisht eshte i orientuar në asfalt, betonizim, mirembajtje dhe sherbime e jo ne zhvillim e transformieren te qytetit une dhe ldk nuk e mbeshtesim

ERZA HASHANI.

I nderuar Kryetar i Komunës së Ferizajt, z.Agim Aliu

I nderuar Kryesues i Kuvendit

Të nderuar drejtor

Kolegë

Media, Shoqëri civile,

Sot, në këtë seancë të Kuvendit, po diskutojmë mbi një pikë të rëndësishme të rendit të ditës, ku përmbledhet puna ekipore e prirë nga Kryetari Aliu për Ferizajn gjatë vitit 2024. Ky raport pune, përfshin një gamë të gjerë të investimeve, punëve publike e mbi të gjitha qasjes për më të mirën për qytetarët që në vazhdimësi eka dëshmuar qeverisja Aliu.

Unë, fokusin në këtë fjalim timin, do ta vë tek dy fusha të rëndësishme së veçantë e që janë e gjelbërta dhe fusha e arsimit.

Në këtë mes, ferizajasit, janë dëshmitarë të dy megaprojekteve që po zhvillohen siç është projekti për parkun në Kodrën e Sherretëve, që përtej një hapësirë të gjelbërt, do të paraqes një pikë të rëndësishme atraksioni për ferizajasit e gjithë bashkëqytetarët tjerë, e po kështu edhe zgjerimi i Parkut “Liria” – që shumëfishon vlerën e tij, me investimet që po kryhen nga ana e Komunës së Ferizajt.

Se e gjelbërta është në fokusin e qeverisjes lokale, dëshmohet edhe me projektin unik, të miniparqeve, hapësira të reja gjelbëruese anekënd Ferizajt, të cilat i shtojnë vlerën investimeve publike e mbi të gjitha krijojnë një ambient më të bukur për qytetarët tanë.

Fushë tjetër, me rëndësi të veçantë ku dua të fokusohem, është edhe arsimit, ku në vitin 2024, Ferizajt iu shtuan edhe objekti i ri i Gjimnazit të Shkencave Shoqërore-Gjuhësore “Dr. Shaban Hashani, e po kështu edhe përfundimi i objektit shkollor “Dy Dëshmorët” Talinoc të Muhaxherëve, objekte këto të cilat ndikojnë ndjeshëm në rritjen e cilësisë në mësimdhënie.

E padyshim, kur flasim për arsimin, Ferizaj, qeverisja Aliu është kampion i gjithë Kosovës, me mbështetje për studentët ferizajas, ku tashmë është shndërruar në traditë, mbështetja për të gjitha aplikuesit për bursën komunale. Vetëm gjatë vitit 2024, u mbështetën me bursë, 1080 studentë ferizajas, për të cilën pra mijëra të rinjtë ferizajas e familjet e tyre, ndjenë mbështetjen e Komunës.

Sa më sipër, pa u ndalur veç e veç në një varg të gjatë punësh publike që pasqyrohen në këtë raport, me gjithë sfidat që është ballafaquar qeverisja lokale, kujtoj se 2024-ta ishte një vit që Ferizajt i solli zhvillim, ferizajasve i solli mirëqenie e mbi të gjitha, vijoi ritmin e pandalshëm të qeverisjes lokale, për ta bërë më të mirë Ferizajn në çdo segment të tij.

Ju faleminderit!

Besim Haziri

Raporti I punës 2024 me lexu najkush këtë raport menon qe është naj vend perendimor pasi qe koleget than gjithqka por unë do të ndalem vetëm me drejtorin e Arsimit që është shume shqetësuese ku për renovim jan shfrytëzu shumë mjete mirpo ka rrjedhje të kanalizimit si psh në shkollën Shaban Hashani e Rizah Matoshi përpos infrastrukturës është edhe shqetësuese niveli I arsimit ku kakueshmeria është shumë më e ulët edhe testi arritshmëris në vitet paraprake, shkolla Zenel Hajdini ku nga 56 nxënës vetëm 16 kan patur rezultat pozitiv dhe kështu në shkollën Faik Konica nga 242 nxënës vetëm 77 kan patur rezultat pozitiv për mua kjo gjendje o keq, Drjror në raport shkrun që jan shpallur 17 konkurse ndonse skam infromacion mirpo thuhet që kan fillu shumë më shumë se 12 mësues puën si është puna këtu pasi që thuhet që po fillojn punën pa konkurs fare,.

Amir Rexhepi para se të fillojmë me raport të punës unë dua që nga këtu ti uroj qytetaret e komunës dhe kryetarit Aliu për dështimin e degradimit të parkut Liria ku do të ketë park dhe kryetar të ftoj edhe ty të dalësh ta shijosh atë park së bashku me ne pasi drejtorja e bujqesis nuk ka lejuar të realizohet disa synime që të bëhet parku burim I dsa përfitimeve të privatëve siq edhe mund ta dini pasi edhe ju më herët kishit shkëmby disa mesazhe e që jan publiku se fundmi, sa I përket raportit ashtu edhe si herav tjera ka ardhur jo për të raportuar por se I obligohet me ligj ku këtu paraqiten gjërat e degraduara , ai është bër mjeshtër i arsyetimeve pasi nëse do të ishte ndryshe do të kishim parë të gjithë mirpo kemi parë një model të pa aftësis e pa përgjegjmeris mirpo mësimi punët e drejtorive I paraqet raporti në dy faqe, sa I përket drejtoris së mjedist kjo qeverisje në vend që ferizaj të jet kampion I së gjelbertes është bërë kampion i

bërllot, unë vij nga fusha e arsimit dhe paramendoni koleg ne skemi ngjyr per printer neve me desht me ba kopje nje test skemi mundësi, hala me keq eshte gjendja në shkollat ku skemi furnizim me land djegse për ngrohje, Kryetar që 3 her rrugën Cen Dugolli te paraqit si project, sa I përket qkmf-s kryetar ajo është project i ministris bre pe shohe te qit naper facebook, Sa I përket sportit kryetar sban me kqyr kto suksese te bizneseve po m undoheni ti merrni sit ë juajat të pash kishe dal të gjimnazi me lu basket ae pe kryetar qfar talente kem po skem klub paramendo vitia e shtimja kan klub ju faleminderit.

Arian Imeri - Sa i përket

Raportit të Punës

Te nderuar kolege ne

para vetes e kemi raportin e punes per vitin 2024 te Komunes tone. **Nga ky raportne shohim nje vazhdimesi te komunes sone**

ne realizimin e planeve dhe projekteve te planifikuara tecilat te shumta kane nisur apo jane realizuar gjate vitit2024.

Ne raport kemi progres ne te gjitha drejtorit me te cilatudheheq ekzekutivi komunal.

Kemi progres ne **infrastruktur e permendi edhe kryetari perurimin e segmentit te pare te nenkalimit te Stacioni i Policis,Stacioni I ri i Autobusave**, pastaj shume projekte tjerainfrastrukture ne qytet dhe fs hatera,

ne arsim- kemi perfundimin e dy shkollave te reja,renovime dhe rregullime ne shume shkolla tjera, perfu ndimi i sallave te edukates fizike, trajnimeprofesionale per mesimdhenes.

ne bujqesi- kemi mbeshtetjen e bujqeve te lemive tendryshme me pajisje dhe mekanizma bujqesore pored he mbeshtetje tjera per zhvillimin e ketij sektori me rendesi. Investime ne ndertimin e dhomave ftohese, ne sillos, ne hipodrom dhe qendren e panairave.

ne shendetesi- kane vazhduar punimet ne QMF-se 2 ne rrugen “Remzi Hoxha”, eshte hap QMF ne Prelez teMuhaxhereve, eshte vene gurthemeli per QMF

ne koshare, jane 2 autoambulanca te reja dhe investimetjera ne ngritje te cilesis se sherbimeve shendetesor e ne komunen tone.

Sa i perket investimeve te gjelberta-

po vazhdojnepunimet te kodra e Sherretëve, te parku Liria (eshte bamire qe eshte nderpre kontrata e Mini stris se Bujqesis),eshte largu kompania KRM “Pastertia”, pasi ka dal ne object te ri dhe eshte hapur mundesia per nje park aty. Ferizaji eshte ranguar me performancen me te mire per menaxhimin e mirembajtjes se hapsirave publike.

ne zhvillim Ekonomik dhe Turizem- Fillimi ipunimeve per rregullimin e qendres Turistike ne Jezerene vler rreth 1 milion euro i keni pa punimet qe kanefillu ne ate pjese. Pastaj mbeshtetje e vazhdueshme e bizneseve, hartimi i strategjis se Zhvillimit Ekonomik, guida turistike. Mbi 1000 biznese te reja te regjistruara.

Sa i perket kultures rinis dhe sporteve- eshte sigurufinancimi per vazhdimin e punimeve per Pallatin e Kultures, eshte hartu projekti zbatues per Stadiumin e Qytetit dhe stadiumi po behet aty ku eshte dasht teb ehed nga fillimi. Jane dhene Bursa studentore per mbi1000 student dhe jane mbeshtetur dhe realizuar shumeaktivitete kulturore dhe sportive gjate vitit 2024.

Sa i perket financave- kemi pasur zbritje per 33% tetatimit neprone

per te gjithë qytetaret dhe bizneset, rritje te te hyrave vetanake per mbi 2 milion euro

ma shume se te hyrat vetanake te planifikuara. Shpensimet financiare gjate ketij viti kane qene 100%.

Per te theksuar kete **vlere te shpenzimeve komunale e lash ne fund ceshtjen financiare.**

Sepse nese ekzekutivi komunal kane realizu te gjithaketo projekte dhe veprimtari ne kuader te ketij viti dh eeshte shpenzu i gjithë bugjeti ne dispozicion ateherecka mundet me **ban nje ekzekutiv ma shumë?**

Nese kishin me mbet mjete te pa shpenzuara dhe nuk jane kry projekte, kishin mundur ti **akuzojme per mospune, mos planifikim te mire, ose nese ka kritika per projektet qe jane kry** dhe nuk jane kry mire, mirpo kur jane shfrytezu te gjitha mundesit financiare kaq jane kapacitetet tona komunale. Dy bugjete mbr enda nje viti nuk mundet mi shpenzu asnjekzekutiv, sepse nuk lejohet kjo pune.

Ne jemi anku vazhdimishte per mosperkrahe nganiveli qendrore, me siguri me perkrahe ma te madhe financiare disa prej projekteve qe jane tu vazhdu ishinkry por kishte mepas edhe shume projekte te reje, mirëpo nje gje e

tillë nuk po ndodhe, tashme kjo punedihet nga te gjithë pse. **Prandaj une e pergzoj ekzekutivin komunal per punen qe ka ba ne baze temundesive reale qe i ka pase.**

VERONA ISAKU

Të nderuar qytetarë

Ky raport i punës që na është paraqitur nuk reflekton asnjë progres konkret,

as përmbushje të objektivave të vitit 2024. Është një raport që, në vend që të përqendrohet në realizimin e premtimeve dhe arritjeve të këtij viti, është një përmbledhje e asaj që ka ndodhur në vitin 2023. Kjo nuk është vetëm një mungesë e transparencës, por një përpyetje për të krijuar një perceptim të pabazuar, për të fshehur atë që realisht ka ndodhur.

Ky është një hendek midis asaj që është raportuar dhe asaj që ka ndodhur në praktikë.

Është thelbësore që raporti i vitit 2024 të trajtojë me sinqeritet

dështimet dhe sfidat që janë hasur gjatë vitit, por ne tashmë e kemi të dëshmuar që udhëhiqemi nga një kryetar frikacak dhe të dështuar, pasi që vazhdimisht na e tregojnë se nuk ka guxim të përballim me të bemat e tija.

Në këtë raport, kryetari i komunës, në vend që të flasë për arritjet dhe përpyekjet e vërteta, nis fjalimin me gënjeshtër.

Ai thotë se janë nisur punimet për zgjerimin dhe rregullimin e Parkut të Lirisë, por kur e shohim nga afër, kuptojmë se ky "zgjerim" nënkupton vetëm rritjen e numrit të bizneseve të gastronomisë, që nuk ka asnjë lidhje me interesin publik.

Po ashtu,

ai potencoi se punimet në stacionin e autobusëve janë përfunduar mirëpo është e pakuptueshme pse nuk po funksionalizohet, pra, ngrihet pyetja se a po

e mban jashtë funksionit me qëllim për t'u përruar gjatë fushatës

Aq nuk ka punuar ky kryetar, sa që e konsideron arritje të tijemërtimin e një sheshi.

Në raportin e punës, kryetari Aliu do të duhej të fliste edhe përskandalet e ndodhur në qeverisjen e tij. Ai do të duhej të përmendte drejtorët e tij, të cilët janë të njohur për kërcënime dhe gënjeshtër. Do të duhej të shpjegonte se si në pushtetin e tij ai qe ofendon dhe shanë, siç ndodhi me drejtorin e shërbimeve publike, ai nuk ndeshkohet, por avancohet në detyra, duke

e emëruar atë zëvendës drejtor në shkollën që udhëhiqet nga nëna e baxhanakut të tij,

e që tani edhe një sekret publik, që parashikon se i njëjti person

do të bëhet drejtor pas daljes në pension të drejtoreshës aktuale. Pra, jeni bërë të parashikueshëm.

Do të duhej të na tregonit se si i keni mashtruar punonjësit e Çerdhës "Engjujt"

duke nxjerrë një kërkesë, ku i lutnit të vazhdonin punën, e kur ne

kërkuam kompenzim për muajin që ata kishin punuar, drejtori juaj doli

me një gënjeshtër publike, kumohoi se u kishte kërkuar një gjë të tillë, ani pse ne

e posedonim kërkesën e tij të nënshkruar dhe të vulosur nga ai më 4 mars të Vitit 2024.

Nuk do të duhej ta linit pas as dore gënjeshtër publike të drejtoreshës së financave,

e cila në një debat publik gënjeu se tenderi ne "Vendlindje Festojmë"

u anulua me arsyetimin se komuna nuk kishte fonde, ndërkohë që në të dy rastet e anulimit arsyetimet ishin krejtësisht të tjera. Në herën e parë u arsyetua se kompania që fitoi tenderin nuk kishte plotësuar disa kushtet teknike, pra nuk posedonte mjaftueshëm instrumente që ishin të nevojshme për festivalin.

E në rastin e dytë u arsyetua se kompania që e fitoi tenderin kishte kërkuar më pak para se ç'kishit menduar ju dhe dukej e paarsyeshme.

Pra, përveç që jeni gënjeshtarë, jepni edhe arsye të banale që vetë një njeri që është larg çdo morali mund t'i përdorë.

Pra, raporti juaj i punës tregon qartë se jeni frikacak,

manipulator, gënjeshtar, të papërgjegjshëm dhe se fshiheni pas një fasade,

duke proklamuar veten si qytetar të mirë e të dashur, kur në të vërtetë jeni krejtësisht e kundërta.

Le të pranojmë një të vërtetë të thjeshtë:

e vetmja gjë e mirë e prezencës tuaj është se të paktën mund të shohim drejtorët tuaj të rreshtuar aty ku e kanë vendin—çdo muaj, natyrisht, dhe jo vetëm atëherë kur ju kanë frikë.

Gjithashtu, ju keni këtë aftësi magjike që me prezencën tuaj, arrini ti bindni kuvendarët tuaj,

pro pazareve që bëhen pas krahëve të tyre, pra jeni një shembull i vërtetë i udhëheqësisë që drejton me dorë të fortë... vetëm kur është në interesin tuaj!

Kryesuesi theksoi se Raporti i punës përfundoj sa i përket diskutimeve, andaj vazhdojmë me rendin e ditës pra vazhdojmë me pikën e 9-të si është e listuar në ftesën për mbledhje dhe ia kalojm fjalën drejtorit Sabri Murseli i cili theksoi se ashtu si e keni në propozim ka të bëjë për caktimin e lokacionit për

ndërtimin e përkohëshëm të zyrëve për organizatën Miqt e familjes Biden, Kryesuesi e hodhi në votim pasi spati të interesuar për diskutim dhe kjo pikë kaloi me 17 vota për 0 kundër dhe 0 abst.

Kryesuesi e lexoi pikën e 10 dhe ia kaloi fjalën drejtorit Sabri Murseli i cili theksoi se këtë pikë duhet ta ndryshojm dhe ta bëjmë vetëm shpallje interes i përgjithshëm i parceles dhe e cila do të kompenzohet me mjete monetare fillimisht të futet në buxhetin e vitit të ardhshëm dhe më pas të procedohet ju falemindederit.

Kryesuesi pasi spati të interesuar për diskutim e hodhi në votim dhe kjo pikë kaloi me 23 cota për 0 kundër dhe 0 abst.

Pika 11,12,13 që kanë të bëjnë me caktimin e lokacionit për buste u votuan si tërsi pa diskutim të gjithë me vota 24. Për 0 kundër dhe 0 abstenim.

Kryesuesi e lexoi pikën e 15 për memorandumit ndërmjet këshillit danez për Refuqgjat dhe Komunës së Ferizajt as këtu pas paraqitjes se pikës nga drejtori Sabri Murseli i cili theksoi se si e keni në material nuk ka asnjë ndryshim nuk pati dhe u votua me 24 vota për 0 kundër dhe 0 abst.

Kryesuesi e lexoi edhe pikën shtesë të cilën e paraqiti drejtori Sabri Murseli për shpallje interes I përgjithshëm të parcelave 3539-0 dhe 3538-0 pasi edhe këtu spati të interesuar për diskutim kaloi edhe kjo pikë me 24 vota për 0 kundër dhe 0 abst.

Kryesuesi e lexoi edhe pikën shtesë për zgjatje të qiras për shtëpin e pensionistëve dhe fjalën e morri Brahim Osmani i cili theksoi se nuk jemi kundër mirpo kryetari pensionistët i ka gënju tash përpos që i ka genju tash po jau pagun edhe qiran po qesh drejtori pasi tha genjeshtrat e krytearit si marrin parasysh, pasi spati tjer për të diskutu edhe kjo pikë kaloi më 24 vota për 0 kundër dhe 0 asbte.

Kryesuesi theksoi se kemi një pikë të paraqitur nga Pakize Bujani fillimisht kjo qështje është më shumë e partis politike dhe besoj që edhe ne si kuvend të ndëgjojm vullnetin e tyre pasi ish nënkryetari ka dhënë dorëheqje nga partia, andaj kush është për shkarkimin e nënkryetarit Danush Ademi i cili u shkarkua me 24 vota për. 0 kundër dhe 0 abst.

Qazim Rahani është propozimi i ri për nënkryetar andaj kush është për dhe kjo pikë kaloi me 24 vota për, 0 kundër dhe 0 abstenim.


Kryesuesi theksoi se duhet të vazhdojmë me Pyetje dhe Kërkesa ?

Amir Rexhepi kam një pyetje pse ndrove mendje kryesues per piken e dakonit pasi para disa dite ke qene kunder ndersa sot a te bindi prizenca e kryetarit apo çfar.


Xhavit Zariqi theksoi se un skam ndrru mendje as pozicion megjithate eshte nje ndryshim dhe mbane mend skemi votu asgje tjeter perpos që te shpallim interes te pergjithshem te prones qe kemi marre dhe kurgja tjeter skemi votu. Dhe se si do te procecohet un se di mirpo ne skemi votu diqka tjeter do ta lexoni vendimin e kuvendit ku do te jete vetem shpallje interes i pergjithsem.

Ju faleminderit per pjesemarrje e shihemi ne mbledhjen tjeter.

Procesmbajtësi


Leutrim Mahmuti

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës


Xhavit Zariqi

